

## **KUVENDI**

### **PROJEKT LIGJ**

**Nr. \_\_\_\_\_, Datë \_\_. \_\_. 2020**

#### **PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR NEGOCIMIN DHE LIDHJEN E KONTRATËS NDËRMJET SHTETIT SHQIPTAR DHE SHOQËRISË “SYMPHONY INVEST LIMITED”, ME OBJEKT RIZHVILLIMIN TURISTIK TË PORTIT TË DURËSIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **KUVENDI**

### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### **VENDOSI:**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Ky ligj përcakton procedurën e veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërisë “Symphony Invest Limited”, me objekt rizhvillimin turistik të portit të Durësit.

##### **Neni 2**

##### **Procedura e negocimit**

Procedura e negocimit për lidhjen e kontratës do të ndiqet nga komisioni i negocimit të kontratës, i cili kryesohet nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe në përbërje të tij ka anëtarë, Ministrin e Financave dhe Ekonomisë, Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrin e Shtetit për Rindërtimin, i cili fillon negociatat brenda 10 ditëve nga momenti i hyrjes në fuqi

të këtij ligji.

Komisioni i negocimit të kontrates mbeshetet nga një grup teknik i ngritur me urdhër të Kryeministrit, me përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shtetit për Rindërtimin, Autoriteti Portual Durrës, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Avokatura e Shtetit dhe përfaqësues nga institucione të tjera që gjykohen të nevojshme.

Komisioni i negocimit të kontratës vlerëson dhe negocion me shoqërinë “Symphony Invest Limited” propozimin e paraqitur prej tyre për rihvillimin turistik të hapësirës së Portit të Durrësit dhe harton projektkontratën finale të negociuar nga palët, shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave. Komisioni i negocimit të kontratës mund të asistohet nga një konsulent, i përzgjedhur sipas një procedure të veçantë, të përshpejtuar, që miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Projektkontrata, e shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda një afati prej 45 ditësh nga data e nisjes së negociatave, i dërgohet për nënshkrim Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

### **Neni 3**

#### **Nënshkrimi i kontratës**

Nënshkrimi i kontratës nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë bëhet brenda afatit kohor prej 10 ditësh nga data e marrjes së projektkontratës dhe relacionit përmbyllës të negociatave.

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë mund t’i kërkojnë komisionit të negocimit të kontratës rishikimin e projektkontratës. Ky komision duhet të rinegociojë dhe t’ua paraqesë për nënshkrim ministrave projektkontratën, të shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda afatit kohor prej 30 ditësh, duke filluar nga data e kthimit.

### **Neni 4**

#### **Miratimi i kontratës**

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë dërgojnë për miratim në Këshillin e Ministrave projektligjin e hartuar nga komisioni i negocimit të kontratës, brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të saj.

Kontrata miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Data e hyrjes në fuqi e kontratës do të jetë data e hyrjes në fuqi të ligjit, pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

## **DISPOZITA KALIMTARE**

### **Neni 5**

Ngarkohet Autoriteti Potrual Durrës të marrë masa për evidentimin dhe trajtimin e kontratave në fuqi në Portin e Durrësit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

### **Neni 6**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**R I**

**K R Y E T A**

**GRAMOZ RUÇI**